



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi

Mbledhja nr. 20

Prishtinë, më 7 qershor 2010, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi

Në mbledhje morën pjesë: Bahri Hyseni - kryetar, Adem Hajdaraj, Bajram Kosumi, Radmila Vujoviq, Gani Geci, Ibrahim Makolli, Armend Zemaj, Selville Halimi, Kolë Berisha dhe Mufera Şinik.

Mungoi: Ramadan Gashi.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Blerim Burjani – KQZ, Miradije Meha dhe Xhemail Peçani – SKQZ, Reshit Gashi – NDI, Lejla Selimi dhe Ardi Shita – OSBE, Krenare Sfishta dhe Ismet Shala – MEM, Isuf Zejna – KDI, Bujar Shala – OSBE, Fatbardhë Zeka – Bota sot, Lumnije Murati - ZPRK, Albulena Ademi dhe Dafina Bardhi – praktikante.

Nga Stafi i Komisionit: Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni, Sulltane Gashi dhe Visar Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Bahri Hyseni, kryetar i Komisionit

Në këtë mbledhje propozohet ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 24 majit 2010,
3. Shqyrtimi i Raportit të Punës së KQZ - së për vitin 2009,
4. Shqyrtimi i Propozimamendamenteve të Komisionit Funkcional në Projektligjin për minierat dhe mineralet,
5. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 24 majit 2010

Kryetari konstatoi se Komisioni e miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 24 maj 2010, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit të Punës së KQZ - së për vitin 2009

Kryetari - Përsëriti prezencën e përfaqësuesve nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, duke shtuar se në pajtim me ligjin KQZ - ja raporton në Kuvendin e Kosovës dhe ne, si Komision, jemi të autorizuar që ta shqyrtojmë dhe të paraqesim rekomandimet për Kuvend. Edhe pse raporti ka ardhur në Kuvend brenda afatit të caktuar, është vonuar disa ditë në Zyrën e Kryetarit, por pa fajin e tij, prandaj është dashur që një kopje t'i dorëzohet edhe Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi. Fjalën ia dha Blerim Burianit që ta prezantojë Raportin.

Blerim Burjani - E prezantoi Raportin duke bërë një përmbledhje të të gjithë aktiviteteve të KQZ - së gjatë vitit 2009. Në vazhdim foli për planin operacional të zgjedhjeve, marrëveshjet e bashkëpunimit, vendimet e KQZ - së që janë nxjerrë 64 vendime, si dhe organizimin dhe implementimin e zgjedhjeve në kuvendet komunale, e që sipas tij, janë ndërmarrë një varg aktiviteteve, me marrjen e një numri shtesë prej rreth 600 punëtorëve. Më tej foli edhe për shërbimin e votuesve, që ka paraqitur sfidë për KQZ - në e që aktiviteti i tij ka qenë informimi dhe edukimi i votuesve. Në pika të shkurta foli edhe për Buxhetin duke ju shmangur përshkrimeve, sepse kjo do t'i paraqitet Komisionit për Buxhet dhe Financa.

Kryetari - Duke folur për Raportin tha se është një raport i shkurtër dhe nga ajo që është përfshirë në këtë raport shihet që nuk është folur asgjë rreth sfidave që ka pasur KQZ - ja, problemet me të cilat është ballafaquar, probleme rreth funksionimit të ligjit aktual, si dhe problemet e kompetencat rreth KZAP - it.

Ibrahim Makolli - Duke u ndërlidhur me parafolësin tha se është raporti më i keq që i ofrohet Kuvendit të Kosovës, sepse kjo çka përfshihet në të do të duhej të ishte një rezymë e tij, e jo një raport që do të duhej të ishte më i hollësishëm, meqë kemi qenë në vitin e zgjedhjeve. Ishte i mendimit që Raporti nuk i plotëson kushtet që të procedohet, sepse përpos që ky raport duhet t'i përmbledhë aktivitetet që ka pasur KQZ - ja, në Raport me zgjedhjet dhe në implementim të ligjit, do të duhej të na shërbente për të parë se çka do të duhej të veprohej në të ardhmen. Është një informatë shumë e shkurtër dhe nuk përmban elementet kryesore që do të duhej t'i përmbajë një raport, duke shtuar se KQZ - ja ka dështuar në garantimin e integritetit të zgjedhjeve.

Bajram Kosumi - Në fjalën e tij bëri një diferencim duke thënë se çështjet që kanë të bëjnë me zgjedhjet dhe mbarëvajtjen e tyre nuk lidhen ekskluzivisht me KQZ - në, është pjesa procedurale ligjore detyrues që lidhet me KQZ - në, por vullneti politik i të votuarit dhe kultura politike nuk lidhen drejtpërdrejt me KQZ - në. Prandaj vërejtjet që do t'i japim në Raport do t'i ndihmojnë KQZ - së që ta plotësojë para se ta procedojmë për seancë. Në vazhdim tha se është e vërtetë që dy herë zgjedhjet nuk kanë shkuar mirë, ndoshta për shkak të mos organizimit të mirë, ose interesit të partive për të manipuluar me një pjesë të votave të qytetareve. Ishte i mendimit që në Raport do të duhej të përfshihej problemet në zgjedhjet e fundit, sidomos në tri komunat, pse janë anuluar zgjedhjet duke dhënë informacionet, në sa vende KQZ - ja ka informacione për keqpërdorimin e votave, si dhe ku është ai material që e argumenton keqpërdorimin e votave, këto tri çështje është dashur të jenë të hollësishme në Raport.

Gani Geci - Ishte i mendimit që për prezantimin e Raportit do të duhej të ishte kryetarja e KQZ - së. Në vazhdim ai shprehu shqetësimet rreth procesit të tejzgjatur zgjedhor. Kjo është dashur të përfshihet në raport që të shihen sfidat lidhur me këto procese. Ceku se problem paraqet dhe keqpërdorimi i votave të qytetareve, e që dikush do të duhej të japë përgjegjësi, që është një nga problemet që janë të njohura për çdo qytetar, si dhe problemet e KZAP - it, duke shtuar se nuk ka pasur një koordinim në mes të tyre. Këto parregullsi që kanë qenë prezentë i kemi tejkaluar për hir të proceseve që mos ta pengojnë Kosovën drejt integriteteve evropiane.

Armend Zemaj - Duke u ndërlidhur me diskutimet e parafolëseve tha se janë zgjedhjet e para të organizuara nga vendoret dhe sigurisht që kjo ka qenë një sfidë. Duke folur rreth përgatitjeve të zgjedhjeve tha se ato janë bërë në bazë të kapaciteteve dhe mundësive, qofshin ato buxhetore ose të infrastrukturës. U pajtua me parafolësit se në Raport mungon përfshirja e sfidave që ka pasur KQZ - ja gjatë punës së tyre. Në diskutimin e tij ngriti një mori çështjesh si: përpilimi i listave të votuesve e që është dashur të pastrohen, edhe pse kjo ka qenë aktuale dhe nuk ka qenë ndonjë problem shumë i madh, si dhe votimet nga diaspora nuk kanë qenë të organizuara mirë. Ai në vazhdim foli edhe rreth mënyrës së organizimit të zgjedhjeve për komunitetet jo shumicë.

Mufera Şinik - U pajtua me parafolësit për çështjet e ngritura dhe shprehu mendimin se Raporti është shumë i shkurtër e që do të duhej të përfshiheshin lëshimet që kanë qenë gjatë procesit zgjedhor. Mori shembull Prizrenin, si një nga komunat që janë përsëritur zgjedhjet, por janë përsëritur edhe lëshimet e bëra në raundin e parë, e që nga ana e KQZ - së nuk janë ndërmarrë masa. Ajo tha se në disa vende ku jetojnë Turqit familjet janë ndarë dhe kanë votuar nëpër fshatrat ku jetojnë boshnjakët, të cilët nuk kanë asnjë lidhje me ta. Pyeti se çka ndërmori KQZ - ja në këtë drejtim?

Selvije Halimi - Përkundër të gjitha atyre problemeve që ka pasur KQZ - ja, megjithatë meriton edhe fjalë të mira, sepse në të ardhmë do të duhej të evitoheshin këto probleme, meqë tani i kanë të njohura problemet. Duke folur për keqpërdorimet e votave tha se nuk është përgjegjëse vetëm KQZ - ja, por jemi edhe ne, partitë politike dhe përfaqësuesit e tyre, që i kanë dërguar në vendvotime. Në vazhdim tha se nëse Raporti kthehet që të plotësohet, do të duhej të përfshihen edhe këto çështje: a keni informata për manipulimet e votave në qendrën kryesore të votimit për kandidatet në kuvendet komunale? A është ndërmarrë diçka në këtë drejtim? Sa ankesa kanë ardhur në KZAP nga kandidatet, të cilat kanë pasur procese se u janë keqpërdoruar votat pas shpalljes së rezultateve, si dhe sa keni bashkëpunuar me Gjykatën Supreme.

Adem Hajdaraj - Duke u ndërlidhur me parafolësit kërkoj sqarim nga përfaqësuesit e KQZ - së, se a mund të anulohet vendimi i KZAP - it nga KQZ - ja, kur ai merr vendim të tillë në përputhje me ligjin. Në vazhdim ngriti çështjen e vonësive në komunikimin e zgjedhjeve, duke shtuar a kanë ndikim partitë politike në këto çështje. Ai në vazhdim foli për bazën ligjore rreth organizimit të zgjedhjeve dhe problemet e shkaktuara në mbarëvajtjen e tyre.

Sqarime shtesë rreth vërejtjeve dhe pyetjeve të drejtuara nga ana e anëtareve të Komisionit dhanë Miradije Meha – SKQZ dhe Xhemal Peçani – SKQZ, ndërsa Blërim Burjani, tha se ky është vetëm raport pune, por jo raport zgjedhor, sepse raportin zgjedhor nuk hezitojmë ta sjellim, sepse ato janë publike deri në detajet më të vogla. Duke sqaruar se ne kemi sjellë vetëm raportin e punës për vitin 2009, vetëm për aktivitetet e punës, por këtu nuk përfshihet raporti zgjedhor.

Kryetari konstatoi se Komisioni në mënyrë unanime, nxori këtë:

PËRFUNDIM

Komisioni vendosi t'i japë afat shtesë dyjavor që në Raport të përfshihen edhe vërejtjet e dhëna nga anëtarët e Komisionit lidhur me sfidat e KQZ - së.

3. Shqyrtimi i Propozimamendamenteve të Komisionit Funksional në Projektligjin për minierat dhe mineralet.

Kryetari paraqiti Propozimamendamentet e Komisionit Funksional në Projektligjin për minierat dhe mineralet, në të cilin Raport ishin të diskutueshëm amendamentet 53, 62 dhe 63.

Pas vërejtjeve të dhëna në këto amendamente ishte konstatim i përgjithshëm që Raporti të procedohet tutje me sugjerimet e dhëna në këto amendamente, që do të jenë pjesë e raportit dërguar Komisionit Funksional nga Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi.

Kryetari konstatoi se Komisioni në mënyrë unanime, nxori këtë:

PËRFUNDIM

Komisioni shqyrtoi Propozimamendamentet në P/L për minierat dhe mineralet dhe vlerësoi se P/L dhe amendamentet e propozuara kanë bazë juridike në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Komisioni sugjeron të rishikohen amendamentet 53, 62 dhe 63.

5. Të ndryshme.

Komisioni shqyrtoi raportet e Komisioneve funksionale në Projektkodin e drejtësisë për të mitur dhe i njëjti procedohet për miratim në Kuvend.

Mbledhja përfundoi në orën 15: 00

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Bahri Hyseni